

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"KLINIKA SHKODËR SALUS" Sh.p.k.**

Sot më datë 05.10.2022, kemi themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "KLINIKA SHKODËR SALUS" Sh.p.k.

*Themeluesit i shoqërisë është:*

1. **Z. Olti Pecini**, atesia Anastas, lindur me 19/08/1977 në Tiranë dhe banues në Tiranë, rruga Hajredin Kumburo, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Leternjoftimin (ID) me Numer Personal H708191770, tel. 0682053172, email: [oltip@yahoo.it](mailto:oltip@yahoo.it).

Në bazë të ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" dhe të akteve të tjera ligjore në fuqi kanë përpiluar dhe nënshkruajnë sot Statutin e Shoqërisë si me poshtë vijon.

**KAPITULLI I**  
**FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1**  
**Forma**

- 1.1. Shoqëria "KLINIKA SHKODËR SALUS" Sh.p.k (në vijim "Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, veprimtaria e se ciles do të regullohet me anë të këtij Statuti dhe nga legjislacioni në fuqi.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Ky Statut është përpiluar në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2**  
**Emërtimi**

- 2.1 Emërtimi Shoqërisë është "KLINIKA SHKODËR SALUS" Sh.p.k.

**Neni 3**  
**Objekti i shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria " KLINIKA SHKODËR SALUS " Sh.p.k krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë:

Ofrim i shërbimeve mjeksore dhe laboratorike, ambulatoriale dhe spitalore jo publike, menaxhimi dhe ndërtimi i ambulatorëve, laboratorike mjekësore dhe qendrave mjekësore, shtëpive të përkujdesjes spitalore në territorin e Republikës së Shqipërisë për pritjen e të sëmurëve nëpërmjet ambulatorëve të vet të specialiteteve të ndryshme, menaxhimin dhe ndërtim i hoteleve, pensione



si dhe te aktiviteteve të tjera komplementare, të lidhura ose të ngjashme me të, ndërtimi, blerja, menaxhimi dhe shitja e pasurive te paluajtshme edhe për përdorime të ndryshme nga sa me sipër. Menaxhimi dhe /ose ndërtimi i strukturave për formimin e mjekëve dhe paramjekëve. Import-eksporti dhe tregtim i materialeve mjeksore dhe farmaceutike dhe të pajisjeve shëndesore. Furnimi i shërbimeve të mirembajtjes së pajisjeve shëndetësore. Import-eksport. Kerkimi dhe prodhimi i ilaceve, materialeve shëndesore dhe pajisjeve mjeksore në përgjithësi. Menaxhimi i shërbimeve komplementare për aktivitet si më lart si për shëmbull shërbime restoranti, farmaci, pastrimi, mbledhja, trajtimi dhe transformimi i mbeturinave.

#### Neni 4

##### Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në: **Rruga 13 Dhjetori, nr.pas 3-463+1-1, ZK.8594, Shkodër.**
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë, hapjen e filialeve, selive dytësore, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë, dhe jashtë shtetit. Asambleja e Ortakëve mund t'ia delegojë këtë kompetencë organit administrativ.

#### Neni 5

##### Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është *e pakufizuar në kohë.*
- 5.2 Shoqëria mund të priset përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## KAPITULLI II

### KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

#### Neni 6

##### Kapitali themeltar.

- 6.1 Kapitali Themeltar i shoqërisë është në vlerë kapitali 100.000 (njëqind mijë) lekë. Pjesmarrja e themeluesve në kapital është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë.

**Z. Olti Pecini**, i identifikuar me Leternjoftimin me Numer Personal. H708191770, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 100.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### Neni 8

##### Zvogëlimi i kapitalit themeltar

8.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar. Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim unanim të Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

8.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

## **Neni 9**

### **Transferimi i kuotave**

9.1 Transferimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes se ortakeve.

9.2. Në një rast të tillë, ortaku që do të transferojë kuotat e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje dhe/ose me Letër Njofimi nëpërmjet adresës elektronike (në vijim "Njofimi"),

(a) numrin e kuotave të ofruara; (b) emrin e blerësit/përfituesit; (c) çmimin e rënë dakort për çdo kuotë, i përcaktuar në çdo rast në para, ose në vlerën në para në rast të një kundërshpërblimi tjetër të mundshëm (në rast shkëmbimi, kompensimi vullnetar, transaksioni, dhe çdo rast tjetër transferimi me shpërblim), ose vlerën e objektit të transferimit në rastin e transferimit pa shpërblim; (d) modalitetet e pagesës; (e) ftesën për të ushtruar të drejtën e parablerjes. Afatet dhe kushtet e mundshme për të cilat është rënë dakort midis transferuesit të kuotave dhe blerësit/përfituesit nuk do të jenë detyruese për ortakët e tjerë të cilët do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.

9.3. Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e Njofimit, Për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, presumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

9.4. Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë.

## **Neni 10**

### **Asambleja e Ortakëve**

10.2 Asambleja e Përgjithshme Ortakëve vendos në unanimitet për ndryshime të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

10.3 Asambleja e Përgjithshme Ortakëve vendos konform ligjit për emërimin e shkarkimin e administratorëve e përcaktimin e shpërblimeve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë, mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve si edhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkates.

## **Neni 11**

### **E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

11.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.

## **Neni 12**

### **Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet**



12.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit/ve, dhe/ose ekspertit kontabël (nëse është emëruar) si dhe të inventarit.

12.2. Asambleja mund të thirret në çdo moment prej Administratorit me iniciativën e tij ose sipas kërkesës që do ti drejtohet Administratorit nga një ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar.

Në këtë rast administratori duhet që brenda 10 (dhjetë) ditësh të thërrasë mbledhjen e asamblese e cila duhet te mbledhet jo me vone se 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike nga data e kërkeses që i drejtohet Administratorit nga një ose disa prej ortakëve.

Asambleja thirret nëpërmjet: a) njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje, b) Postë elektronike.

Njoftimi me postë elektronike konsiderohet i kryer me kalimin e 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga nisja e njoftimit. Njoftimi per secicilin ortak dergohet në adresat respektive përshkruar në hyrje të këtij akti.

12.3 Lajmerimi do t'u dërgohet ortakëve, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblese. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes.

12.4. Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuorumit, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.

12.5. Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës, pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes.

12.6. Asambleja konsiderohet e mbajtur rregullisht nëse Asambleja mbledhet në selinë e shoqërisë. Asambleja konsiderohet se mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit e të vendmbajtjes në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.

12.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.

12.8 Për drejtimin e punëve në çdo Asambleja zgjedh një Kryetar, ortak ose ndonjë person tjetër jo-ortak i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit. Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

12.9 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Ortaket.

### **Neni 13**

#### **Njoftimi**

13.1. Njoftimi i ndërsjelltë ndërmjet Administratorit, Personelit drejtues dhe bashkepunëtorëve të shoqërisë, do të realizohet nëpërmjet:



- a) njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje,
- b) poste elektronike:
- c) njoftimit ne faqen zyrtare elektronike të shoqërisë;

13.2 Njoftimi me postë elektronike konsiderohet i kryer me kalimin e 10 (dhjetë) diteve kalendarike nga nisja e njoftimit. Njoftimi për secilin ortak dërgohet në adresat respektive përshkruar në hyrje të këtij akti. Administratori, Personeli drejtues dhe bashkëpunëtorët e kontraktuar nga shoqëria duhet te depozitojne ne shoqeri adresen e tyre elektronike si edhe çdo ndryshim eventual te tyre;

13.3. Njoftimi nepermjet faqes zyrtare elektronike te shoqerise konsiderohet i kryer me kalimin e 10 (dhjete) diteve kalendarike nga publikimi i njoftimit ne faqen zyrtare elektronike te shoqerise.

#### **Neni 14** **Administrimi**

14.1. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

14.2. Shoqëria administrohet nga një Administrator, Administratori do te qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej 5 (pese) vjet, deri në shkarkimin apo dorëheqjen e tij. Administratori ka të drejtën për tu rizgjedhur, nëse Asambleja nuk do të vendosë ndryshe përpara përfundimit të detyrës së Administratorit.

14.3 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet **Znj. Fatjona TITE**, atesia Agron, lindur më 20/06/1989 në Berat dhe banuese në Tiranë, rruga Muhamet Gjollesha, madhore e me zotesi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me Leternjoftimin (ID) me Numer Personal I95620002A, e mail : f.begaj@salus.al.

  
(nënshkrimi)

14.4 Administratori/ët mund të ushtroj/në të gjitha fuqitë konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe në çdo rast duke respektuar kufizimet te mundeshme te përcaktuara në aktine tyre të emërimit dhe/ose nga Statuti si edhe nga vendime te mevoneshme te vlefshme te Asamblese se Ortakeve.

14.4 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

#### **Neni 15** **Eksperti kontabël i autorizuar**

15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund ti besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.

15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

**KAPITULLI IV**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

**Neni 16**  
**Viti financiar dhe bilanci vjetor**

16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.

16.2 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji n. 9901 te dates 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

16.3 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

**Neni 17**  
**Fitimet**

17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpëndohen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.

17.2 Asambleja mund të vendosë zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

**KAPITULLI V**  
**SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18**  
**Prishja**

18.1 Shoqëria mund të priset në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi unanim të Asamblesë së Ortakëve

18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

**Neni 19 –Likuidimi**

19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.

19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.




19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Ky akt është përpiluar në përputhje të plotë me vullnetin e lirë dhe të plotë të nënshkrueseve të tij.

#### **ORTAKU THEMELUES**

**Z. Olti PECINI**

A handwritten signature in cursive script, reading "Olti Pecini", is written above a horizontal dashed line. Below the line, there is a large, stylized flourish or mark.

